



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	24.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKK	3699/2022		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 390/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr. 2213/2019, të datës 07.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrativë, kanë shqyrtuar ankesën A.nr. 390/2019, të datës 09.07.2019, së ankuses [redacted] me adresë banimi rruga [redacted] nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Gjykata Supreme e Kosovës, në çështjen juridike "kompensimi material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 390/2019 e datës 09.07.2019, e parashtruar nga ankuesja.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.198/2019 i datës 28.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës Supreme të Kosovës.

### Arsyetim

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, me datën 30.04.2019 ka nxjerr Vendim me numër 148/2019 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuses, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesja \_\_\_\_\_ me datën 20.05.2019, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 713/2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Supreme të Kosovës me datën 28.05.2019 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 198/2019, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar në ligj.

Ankuesja \_\_\_\_\_ e pakënaqur me Vendimin me numër 198/2019, të datës 28.05.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit ligjor Ligjit Nr. Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 09.07.2019 parashtron ankesë, me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të tij duhet ti bëjë pagesën e tri (3) jubilare dhe dy (2) pagave përcjellëse sipas marrëveshjes se përgjithshme kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Gjykata Supreme e Kosovës, për përgjigje në ankesë me datë 15.07.2019, ndërsa me datën 17.07.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Gjykata Supreme e Kosovës, me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kohën e parashtrimit të ankesës nga ankueses ka qenë jofunksional rrjedhimisht nuk është shqyrtuar ankesën e ankueses për këtë ankuesja përmes njoftimit të datës 26.08.2019 është njoftuar, duke e udhëzuar që mund të inicioj konflikt administrativ sipas Ligjit për Konfliktet Administrative. Ankuesja ka hapur konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 07.04.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2213/19me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses (ankueses) duke e anuluar njoftimin e datës 26.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin të shqyrtoj ankesën e ankueses.

**Administrimi i Provave, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A. Nr. 390/2019 e parashtruar më datë 09.07.2019, me numër protokolli 3085/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A.nr. 2213/2018 i Gjykatës Themelorë në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin e datës 28.05.2019, me numër protokolli 198/2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 30.04.20189, me numër protokolli 148/2019, për përfundimin e marrëdhënies se punës për shkak të arritjes se moshës se pensionimit; Ankesa e datës 20.05.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Procesverbali i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; flete dërgesë e datës 31.05.2019; Përgjigje në ankesë e datës 19.07.2019, me numër protokolli 3244/2019, me shkresat e bashkangjitura; Njoftimi i datës 26.08.2019, me numër protokolli 3862/2019, i Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, nga ankuesja dhe organi i punësimit ka konstatuar se ankesa e ankueses

*është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës parasheh që punëtorëve ju takon pagesa në lartësi prej dy paga përcjellëse dhe tri pagave jubilarë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës"*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *"Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit"*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankueses me rastin e pensionimit i ka përfunduar sipas Vendimit me numër protokolli 148/2019 të datës 30.04.2019 të Kryetarit të Gjykatës i Gjykatës Supreme, atëherë kompensimi i dy pagave me rastin e pensionimit sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk mund të bëhet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të listës së pagave të muajit maj 2019 ankueses i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, sipas dispozitave të nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *"Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit". Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit"*, rrjedhimisht Gjykata Supreme e Kosovës, ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, kështu që pretendimet ankimore të ankueses

për kompensimin e dy pagave me rastin e pensionimit sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon që duhet ti bëhet kompensimi i tri pagave jubilarë sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve të Ankesave i Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 198/2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.390/2019**

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën Supreme të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

